



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 2232/12 Prot.

Tiranë, më 30.09 2025

V E N D I M

Nr. 222 datë 30.09 2025

PËR
SHPALLJEN E KONKURSTIT PËR PRANIMIN E 1 (NJË) PUNONJËSI, PERSONEL
AKADEMIK ME KOHË TË PJËSSHME NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË
FIZIKE DHE REKREACIONIT PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË
TIRANËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në Udhëzimin e MASR me nr. 29, datë 10.09.2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë*", në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 46, datë 22.09.2025 "*Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik për tre njësitë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026*", si dhe në shkresën e Dekanit të FVFR me nr. 2232/1 prot., datë 26.09.2025 "*Përcjellje për miratim e kriterëve për rekrutimin e 1 (një) punonjësi, personel akademik (Kategoria As/Lektor) me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit në FVFR*", Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në web-in <http://www.ust.edu.al> të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË SPORTIT DHE TURIZMIT

1 (një) Asistent Lektor.

Lënda : "**Pedagogji dhe Didaktikë e Sportit**"

Moduli : "**Pedagogji e Sportit**"

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Asistent Lektor, Lënda; "**Pedagogji dhe Didaktikë e Sportit**" dhe në modulin: "**Pedagogji e Sportit**" janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e Shkencave Sociale/Psikologjisë/Pedagogjisë, në përputhje me pozicionin e punës.
2. Kandidati që konkuron për pozicionin e punës "As/Lektor" duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
3. Kandidati duhet të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave mbi 8 (tetë).
4. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
5. Të mos ketë cënuar ose prishur imazhin e UST-së.
6. Dëshmi Penaliteti/formular i vetëdeklarimit.

Kritere specifike:

1. Të ketë specializime në fushën e kërkuar.
2. Të ketë përvojë pune në mësimdhënie në arsimin e lartë në specialitetin e kërkuar.
3. Të ketë përvojë kërkimore/shkencore në fushën e kërkuar.

Kritere preferenciale:

1. Të ketë marrë pjesë në projekte kombëtare/ndërkombëtare në fushën e kërkuar.
2. Të ketë marrë pjesë në aktivitete kombëtare/ndërkombëtare (seminare, workshop, trajnime etj.)
3. Të jetë ose të ketë qenë bashkëpunëtor i UST-së.

II Kandidatët që do të aplikojnë për këtë vend pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon;
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues);
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

III Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

1. Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

IV. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.
- V. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- VI. Deri në datën 07.10.2025, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 09.10.2025 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.
- VII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.
- VIII. Dekanati i FVFR, përcjell listën përfundimtare brenda datës 13.10.2025, për miratim në Rektorat.
- IX. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FVFR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *web-in* <http://www.ust.edu.al>.
- X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Agron KASA

